

DR.LLM. Elona Bano, ka kryer studimet doktorale në shkencat juridike pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës me temë “ E drejta për proces të rregullt ligjor, vështirë krahasues”. Ka përfunduar studimet master për të Drejtën Ndërkombëtare Publike në Universitetin Shtetëror "Miqësia e Popujve", Moskë, Federata Ruse. Më parë ajo ka studiuar për drejtësi në Universitetin Shtetëror "Ovidius", Konstancë, Rumani ku ka kryer edhe studimet e mesme. Znj. Bano ka një eksperiencë 12 vjeçare në mësimdhënie në fushën e së drejtës ndërkombëtare publike dhe private si dhe në fushën e të drejtave të njeriut. Znj. Bano ka mbajtur prozicione të larta drejtuese si Këshilltare Ligjore e Presidentit të Republikës, Drejtoreshë e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoreshë Kabineti pranë Ministrisë të Shtetit për Diasporën dhe Drejtoreshë Ekezekutive e Agjencisë Kombëtare për Diasporën, aktualisht është pedagoge me kohë të plotë pranë Universitetit Marin Barleti. Znj. Bano ka një eksperiencë të gjerë në fushën implementimit të projekteve si dhe ka pasur disa angazhime si këshilltare ligjore ku vlen të përmendet angazhimi pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën ligjore pranë Kuvendit të Shqipërisë. Prej vitit 2012 mban titullin avokat si dhe prej vitit 2017 mban titullin e përfaqësuesit të autorizuar për regjistrimin e markave dhe patentave. Ka marrë pjesë në mbi 20 konferenca Kombëtare dhe ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit (Francë, Çeki, Greqi, Itali, Rumani etj.) si dhe ka disa artikuj shkencorë në revista me faktor impakti. Zotëron gjuhën angleze, rumune, ruse, italiane, gjermane dhe ka njohuri shumë të mira të latinishtes.